



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
 OPŠTINA LIPLJAN
 MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 12-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 31.10.2022, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Nexhmedin Lekiqi, anëtar
3. Shefki Bytyqi, anëtar
4. Gazmend Qerkini, anëtar
5. Shkelzim Olluri, anëtar
6. Albiona Tasholli, anëtare
7. Fadil Sopa, anëtar
8. Xhyla Dedushaj-Rexhepi, anëtare
9. Sami Bytyqi, anëtar
10. Fitim Shala, anëtar
11. Xhyzide Rustemi, anëtare
12. Rinor Murati, anëtar
13. Armend Grajqevci, anëtar
14. Majlinda Sylejmani, anëtare
15. Gentianë Hoxhaj, anëtare
16. Venhar Agushi, anëtar
17. Lulzim Rustemi, anëtar
18. Herolind Kozhani, anëtar
19. Ardit Cani, anëtar
20. Arsim Jashari, anëtar
21. Egzona Bytyqi, anëtare
22. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
23. Ganimete Qeriqi, anëtare
24. Alban Salihu, anëtar
25. Fitim Meziu, anëtar
26. Fadil Spahiu, anëtar
27. Fatmir Fetahu, anëtar
28. Shahadije Dragacina, anëtare
29. Besiana Sylja, anëtare
30. Enver Kryeziu, anëtar
31. Bashkim Budakova, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Diamant Bytyqi, Nënkyetar i Komunës
3. Lulzim Qerimi, Nënkyetar i Komunës
4. Latif Ramadani DBF
5. Anila Reçica, DKRS
6. Valon Pacolli, DEZH
7. Shkelzen Hajdini, DSH
8. Flamur Sylejamni, DI
9. Elmaze Behluli, DA
10. Sead Aliu, DI
11. Rexhep Rexhepi, DBP
12. Rasim Hasani, DA
13. Safete Amerllahu, DGJK
14. Safet Krasniqi, Auditor i brendshëm
15. Shemsi Azemi, Shef i Tatimit të Pronës
16. Përfaqësues të medieve dhe shoqërisë civile dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin në këtë mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit tha rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 11-të e Kuvendit.
2. Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Shtator 2022.
3. Raporti i Përformancës së Komunës së Lipjanit për vitin 2021.
4. Propozim Vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023.
5. Diskutimi i Planit të veprimit për adresim të rekomandimeve të ZKA.
6. Diskutimi i Raportit të Auditorit të brendshëm dhe planit të veprimit për adresimin e rekomandimeve.
7. Propozim vendim për përcaktimin e formës, përmbajtjes dhe përdorimit të Flamurit të Komunës së Lipjanit.
8. Propozim Rregullore për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike.
9. Propozim Vendim për ndarjen mjeteve financiare për qendrën për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve-Strehimoren për mbrojtje të viktimave të dhunës familjare dhe atyre të dhunës gjinore.
10. Propozim Vendim për zëvendësimin anëtarit të komisionit vlerësues për shqyrtimin e dokumentacionit për vendosjen e bizneseve në Zonën Ekonomike "Parku Industrial" në Qylagë-faza e parë.

Pastaj kryesuesi tha se, do ta kemi edhe një pikë shtesë të cilën e kemi pas në seancën e kaluar por është kthyer për rishqyrtim nga ministria.

11. Propozim vendim për ndryshimin e titullarit të paluajtshmërisë nga shkolla fillore, në Banullë të komunës të Lipjanit.

Pastaj Kryesuesi pyeti se a ka vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës?

Arsim Jashari, tha se është kanë mirë që këtë pikë me lanë për seancën e ardhshme, pasi që materiali na erdhi me vonesë,po ashtu është mirë që të mbetet emri ashtu siç ka qenë nga vitet 1945. Kisha propozuar që kjo pikë të shtyhet në seancën e ardhshme.

Daut Azemi, tha se sa për sqarim, kjo pikë është votuar në mbledhjen e kaluar, dhe na është kthyer për rishqyrtim prapë nga ministria,dhe na e kemi afatin 30 ditë për me qit në rishqyrtim vendimin ose me plotësuar ose me anuluar.

Meqë vërejtje tjera nuk pati, Kryesuesi vuri në votim rendin e ditës të propozuar dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 31 vota për, aprovoi rendin e ditës..

Pastaj u kalua në Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Daut Azemi, ne bazë të rregullores se punës se kuvendit, duhet të bëni vetëm pyetje jo diskutime e komente, dhe se bashku me zyrtarin e kuvendit do t'i marrin emrat për secilin që është i interesuar te bëjë pyetje.

Armend Grajqevci, tha se kam disa kërkesa, e para ka të bëjë me vendosjen e barrierave te ura në fshatin Ribar i Madh. Kërkesa e dytë ka të bëjë me vendosjen e policëve të shtrirë në rrugën "Hajredin Bajrami" përballë shkollës "Ismail Luma" nëse ka mundësi pasi që në atë rrugë po vozitet me shpejtësi të madhe.

Lulzim Rustemi, tha se kam dy kërkesa që të jetë një informatë detale nga DKA-ja, për 3 ciklet e arsimit në muajin nëntor. Kërkesa e dytë në muajin dhjetor të jetë një informatë detale nga Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim, për pronat komunale të cilat do të ipen me qira. Dhe një pyetje ka të bëjë me ndriçimin publik që pas orës 24:00 të ndërpritet ndriçimi, dhe nuk e di apo zbatohet ose jo?

Fadil Spahiu, tha se duke u bazuar në kërkesat e qytetarëve dua të ngris dy kërkesa: Banorët e fshatit Banullë, kanë kërkuar që të riparohet rruga e quajtur "Rruga e Lamës ", riparimi të bëhet në pjesët anësore të rrugës me zhavorr, pasi që rruga është e ngushtë, përballë kalimi i automjeteve është i pamundur të bëhet në pjesën e asfaltuar dhe njëra veturë duhet patjetër të kalojë në pjesën jashtë asfaltimit gjatë përballë kalimit. Dëmtimi i këtyre pjesëve është bërë si pasojë e qarkullimit të

madh të automjeteve, sepse kjo rrugë është edhe rrugë lidhëse e fshatit Banullë dhe Gllogoc, si dhe forma e rrugës është me shumë kthesa të mëdha dhe kjo e rritë rrezikun e aksidenteve. Riparimi të bëhet para se të filloj sezoni dimëror sepse mjegullat dhe dëbora e vështirësojnë tej mase qarkullimin e automjeteve në këtë rrugë. Kërkesë për bartjen e mbeturinave: Banorët e fshatit Gadime e Epërme dhe Gadime e Ulët kanë bërë kërkesë që të kontraktohet ndonjë kompani nëse nuk është kontraktuar deri më tani për bartjen e mbeturinave nga shportat statike të vendosura nga Komuna nëpër rrugët e fshatrave Gadime e Epërme dhe Gadime e Ulët, sepse shportat janë vazhdimisht të stërmbushur me mbeturina.

Besiana Syla, tha se unë do ta ngris në qeshtje ,mungesën e stacionit të autobusëve, pasi që autobuesët si mundesi po e zgjedhin oborrin e shtëpisë së kulturës ose tregun e gjelbër. Unë si anëtare e kuvendit, por edhe qytetarët e Lipjanit duhet t'i dijme planet konkrete rreth kësaj qeshtje që nuk ka zgjidhje nga pas lufta.

Nexhmedin Lekiqi, tha se nëse del në fshatrat e komunës së Lipjanit nuk kanë stacione ku një udhëtar do të hynte brenda në të dhe do të priste busin. Na duhet ta bëjmë një plan që të ju bëjmë një zgjidhje këtyre qytetarëve.

Rinor Murati, tha se pari mirënjohe të gjithë atyre që janë angazhuar në parandalimin e kancerit të gjirit. Unë kam një kërkesë që ndriçimi publik i cili po ndalet pas orës 23:00, nëse do të kishte mundësi që disa zona më të frekuentuara të kenë ndriçim publik edhe pas kësaj kohe.

Arsim Jashari, tha se i kam dy kërkesa të qytetarëve: e para ka të bëjë me banorët e fshatit Marevc për rregullimin e trotuarit deri në fshatin Llugaxhi, pasi që nxënësit e asaj pjese shkojnë në shkollë në Llugaxhi, dhe ndriçimi është përfunduar a pritet që edhe trotuari të bëhet. Kërkesa e dytë vendosja e kablllove të inernetit që po vendosen nëpër shtylla elektrike në fshatra nga kompani të ndryshme, ku i kanë devijuar shtyllat a ka dikush përgjegjësi se si duhet të vendosen ato, aka ndonjë rregullore a janë të licenuara këto kompani apo në çfarë mënyre po i vendosin ato kablllo. E kam një propizim që të i ftojmë bizneset e Lipjanit që të ju ndihmojmë klubeve sportive në Lipjan. E kam një shqetësim për kompaninë e cila po e mirëmban sheshin, e cila ju është prishur dhe sheshin e ka bërë me vaj.

Shahadije Dragaçina, tha se në Janjevë kanë filluar punimet në ndërtimin e varrezave, por po na intereson neve dhe qytetarëve me ditë se sa kanë kushtuar ato investime në atë vend pasi që ende pa kaluar një muaj aty kanë filluar të prishet ato muri i ndertuar ,është para rrëzimit. A keni kërkuar përgjegjësi për këtë qeshtje. E

dyta ka të bëjë me rregullimin e kanalizimit të disa familjeve në fshatin Teqe. Pse edhe pas disa kërkesave të shumta, që disa muaj nuk është bërë zgjidhje për transport për banorët e Janjevës?

Egzona Bytyqi, tha se i kam dy kërkesa, pasi që ishim në muajin Tetor i njoftur si muaji Rozë kërkesa ime është me pas një kordinim në mes të Komitetit për Shëndetësi, Drejtorait për Shëndetësi dhe zyrës së Kryetarit që të bëhet një fond që do të ju ndihmohej atyre të cilët janë të prekur me këtë sëmundje. Tjetra para disa dite ndodhi një rast tragjik në komunën tonë në fshati Risinoc, ku e humbën jetën dy prindet, dhe do të ishte mirë që të ju ndihmohej kësaj familje nëse kemi mundësi. Ku ju shprehi ngushllime asaj familje.

Fitim Mëziu, tha se në QKMF e kemi një Mamograf, i cili nuk është funksional a pritet që ky Mamograf të bëhet funksional, pasi për qytetarët sa më herët të zbulohet kjo sëmundje edhe shërimi do të jetë më i lehtë.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se unë kam kërkesë që të jetë një Mamograf në QKMF, pasi që ai është jo funksional dhe nëse nuk mund të riparohet të blehet një Mamograf i ri. Do të ishte mirë që të shikohet mundësia që të kemi edhe një Radiolog shtesë dhe një ultrazë të gjirit. Po ashtu e kam një kërkesë për drejtoratin e Shërbimeve Publike që të vendoset një shenjë te rrethi, te Janjeva, pasi që në atë rrugë nuk ka shenjë për ata që vijnë nga Janjeva dhe hyjnë në rreth.

Alban Salihu, tha se kam një pyetje për drejtorin e shëndetësisë, ku para disa dite ne e kemi vizituar QKMF-në në Lipjan dhe na kanë njoftuar, ëe rengen nuk është funksional, a është funksionalizu ai rengen. Pyetja e dytë ka të bëjë me drejtoratin e Shërbimeve Publike pasi një banore e fshatit Gadime na ka njoftuar se kompanitë e autobusëve i kanë larguar mujoret dhe kjo ka ndikuar te qytetarët e në veçanti te nxënësit.

Albiona Tasholli, tha se e përgëzoj kryetarin e komunës z,Imri Ahmetin, për vendimin e marrë për, rritjen e numrit të përfituesve të bursave për studentët e komunës së Lipjanit nga 120 në 160 bursa komunale. Një vendim shumë i drejtë në kohën më të duhur. Po ashtu kam një kërkesë të bëhet një fondacion për lexuesin më të mirë të vitit. Tjetra kërkoj që nxënësit në shkollat e komunës së Lipjanit mos t'i ndërrojnë më të mbathuart pasi që kjo po ndikon te nxënësit, ku po ju rëndohen qantat e shkollës dhe në shkolla nuk është që po zbathen drejtori dhe stafi tjetër i shkollës. Po ashtu propozoj që të vendosen kabinat e pritjes së autobusëve nëpër

fshatrat e komunës së Lipjanit. Mbeturinat ne fshatin Gadime mblidhen cdo të mërkure.

Ganimete Qeriqi, tha se këtë muaj kemi pas aktivitete për kancerin e gjirit, ku i falenderoj të gjithë për kontributin. Por kemi harruar edhe një ngjarje të madhe, gjurmët e Shtjefan Gjeqovit, ku nuk rreshti kurrë së punuari për kombin tonë, për arsim e klaturë e për këtë veprimtari edhe u privua nga jeta. Lipjani pak po punon për te, në të ardhmen duhet të ketë një shtatore të Gjeqovit në Lipjan, po ashtu edhe ndonjë shesh duhet të bartë emrin e tij.

Bashkim Budakova tha se kam me një ngrit një shqetsim për qentë endacak ku është ngritur disa herë edhe nga kolegët në kuvend, dhe është hedhur faji në nivel qendror, ndërsa me një takim me AVUK-un, na kanë thënë qe është kompetencë direkte e komunave, dhe me këtë ju po i ikni përgjegjësisë dhe për këtë duhet të bëhet një zgjidhje.

Fadil Spahiu, tha se unë nuk përmenda asnjë kompani me emër por duhet të kontraktohen një kompani për shportat statike.

Dimant Bytyqi, nënkrytar i komunës tha se, sa i përket qenve endacka ne në seancen e kaluar kemi ndarë mjete dhe do të merremi seriozisht me këtë çështje. Sa i përket festivali për Shtjefan Gjeqovit ne do të bënim por ajo është kompetencë e ministrisë. Qështja e mbeturinave është përgjegjësi e kompanisë së pastrimit. Sa i përket fondacionit për të prekuar me kancer ne ju kemi ndihmuar disa rasteve me subvencione vec e vec. Nuk e di a do të mund te ndikojmë te kompanitë e autobusëve që të kenë mujore ose jo. Qështja e varrezave në Janjevë ju ka shkëputur kontrata kompanisë, ndërsa sa i përket transportin në Janjevë nuk ka asnjë operator që dëshiron të hyjë në Janjevë. Trotuari në Marevc do të kryhet së bashku me ndriçim. Klubeve sportive ju kemi ndihmuar disa herë me subvencione. Kemi pas takime dhe me përfaqesues të kompanive të ndryshme. Sheshin kompania do ta pastroj. Për informatat të cilat i kerkoj Luli, i keni edhe në plan të punës së Kuvendit dhe do t'i keni në kuvend. Ndërprerja e ndriçimit publik po bëhet në ora 23:00, ndërsa rrugët e qytatit jo. Stacioni i autobusëve është në kontest gjyqsor. Ne jemi me një projekt ku do të vendosen ne 12 kabina në disa fshatra për pritjen e autobusëve. Kanalizmi në Teqe kemi ndërhyr të disa familje.

Rasim Hasani, tha se përket mbathjeve të nxënësve në shkolla e kanë një rregullore të brendshme po ashtu e kanë edhe këshillin e shkollës.

Daut Azemi, tha aty ku zbathen nxënsit duhet të zbathen të gjithë stafi i shkollës jo disa po disa jo.

Shkelzen Hajdri, tha i falnderoj të gjithë ata që janë angazhuar në muajin rozë. Ka disa vite që Mamografi është jashtë funksionit dhe nuk po mundemi ta rregullojmë pasi është model i vjetër. Po ashtu edhe rengeni është jashtë funksionit dhe asnjë kompani nuk po mundet ta rregulloj pasi që është shumë i vjetër. Javët tjetër do ta sjellim një rengen të ri si donacion në QKMF. Në shëndetësi ne Lipjan është duke u punuar që të ju ofrohen të gjitha kushtet stafit aty, në mënyrë që të bëjmë më të mirën për qytetarët tonë. Shërbimet e radilologjisë pat kërkesë që të rriten, por ne ende jemi duke e bërë një analizë se ku kemi më shumë nevojë të investohet.

Fitim Mëziu, tha ju përgëzoj për punën, por dikush duhet me dhënë përgjegjësi pse e njeita qasje nuk ka ekzistuar më herët dhe pse kanë qenë ato ngecje.

Arsim Jashari, tha se hale po kemi problem me i ditë kompetencat të cilat e kemi ju me ja hudh faji njëri-tjetrit.

Daut Azemi, tha se na kemi pikë tani në rend të ditës që ndryshe e thotë ligji ndryshe udhëzimi

Pasi që çështje tjera nuk pati u kalua me punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 11-të e Kuvendit.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktet të cilat i keni marrë.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Pastaj Kryesuesi vuri në votim ekstraktet nga mbledhja e 11 e Kuvendit, , pas votimit konstatoi se Kuvendi me, 30 vota për aprovoi

Ekstraktit nga mbledhja 11-të e Kuvendit.

Shtesë: Ekstrakti

II.

Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Shtator 2022..

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i'a dha fjalën, Latif Ramadani, DBF,i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Besiana Syla, tha se te ky raport e kemi një shpenzim jo të kënaqshëm e sidomos te investimet kapitale. E dijë që ka pas probleme për shkak të çrregullimit të tregut, por buxheti është i shpenzuar pak kur dihet që kanë kaluar 9 muaj të vitit. Unë e kam një pyetje për kryetarin çka ka ndodhur me mjetet e fituara nga performanca që nuk është shpenzuar as edhe një cent. Edhe te grandit qeveritar i shfrytëzimit deri diku është i kënaqshëm . Ekzekutimi i pagesave nga thesari pse po lihen të shkojnë në thesar kur komuna ka mundur t'i kryej me kohë këto pagesa.

Lulzim Rrustemi, një raport voluminoz shifet që koha është sfiduese dhe kemi shpenzime të vogla. Te fondet burimore është një shifër e ulët e shpenzimeve. Shpenzimet e Grandit qeveritar 60% i shfrytëzuar buxheti, dhe ka sfide që të shkoj suficit buxheti. Më shqetësuese janë mjetet te investimet kapitale. Të hyrat vetanake të bartura edhe këtu kemi buxhet të vogël të shpenzuar. Te shërbimet publike te grandit qeveritar kemi shpenzime të vogla po ashtu edhe te drojtaratet tjera kemi ashtu shpenzim të vogël të buxhetit. Te kujdesi primar shëndetësor këtu kemi zero shpenzime. Investimet kapitale në Lipjan nga grandit qeveritar më shumë se gjysma e projekteve janë me shpenzim zero. Planifikim i të hyrave është mirë kemi një përgjigje të mirë të qytetareve ndaj tatimit në pronë. Te legalizimi i objekteve është bërë pak punë. Nëse e krahasojmë me vitin e kaluar kemi rritje dhe është një shifër e mirë. Te shërbimet kontraktuale kemi shpenzime të mëdha në se cilat drejtorate janë bërë këto shpenzime dhe për far shpenzime duhet te ceken. Në përgjithësi kemi një buxhet të vogël të shpenzuar.

Latif Ramadani, mjetet e performaces është bërë alokimi në muajin maj, dhe nuk kemi mujt me i shpenzuar. Pagat jubilarë nuk ka meny tjetër te pagesës përveç përmes thesarit. Projektet me Demos edhe aty kanë ardh mjetet me vonese por kanë filluar tani disa projekt ne teren te zhvillohen

Pasi që çështje tjera nuk pati u kalua me punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

III

Raporti i Përformancës së Komunës së Lipjanit për vitin 2021

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i'a dha fjalën, Shemsi Azemi, shef i tatimin në pronë i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti

Pastaj kryesuesi, hapi diskutimin?

Armend Grajqevci, tha se një raport për lavdatë, ku e falënderoj kryetarin për punën e mirë. Nuk është hera e parë që po dalim në top vendet më të mira për përformancën. Me këtë punë të ekzekutivit shpresojmë, që do te jemi prapë komuna e parë në Kosovë.

Rinor Murati, tha se e falënderoj ekzekutivin për punën e mirë në raportin e përformancës. Dua të theksoj se në Komitetin për Kulturë Rini dhe Sport, kemi pas diskutim për punën e DKRS-së dhe e përgëzoj drejtoratin për punën e mirë në arritjen e rezultateve.

Lulzim Rrustemi, tha se një rezultat i mirë i arritur te ky raport, dhe kjo po ep një punë të saktë. Dhe me këtë raport na jepet ndihma më e madhe se ku duhet të punohet. Por duhet të ju epet prioritet edhe disa fushave tjera përmes buxhetit dhe debateve të ndryshme me qytetarët. Por nuk duhet të jemi të vet kënaqur me punën të cilën po e bëjmë.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha jo veç që është një pasqyre por na jem një pasqyrë se në cilat drejtime duhet të punojmë me shumë. Të gjithat të dhënat e parashtruara janë të sakta dhe punojnë një ekiye e zyrtarëve që i udhëheq koordinatori Shemi. Ka edhe disa fusha qe nuk jemi mirë. Unë i falënderoj Demosit që hapësirën që ju ka dhënë komunave në veçanti Lipjanit.

Lumturije Bytyqi, kam një pyetje te pika 16 përfaqësimi gjinor ku e kemi një përqindje jo reale, pasi që përqindja e grave në ekzekutiv është jo e kënaqshme.

Shmesi Azemi, tha se kjo është në bazë të dhënave të marra nga raporti dhe është e sakte dhe këto të dhënë verifikohen edhe nga MAPL-ja

IV

Propozim Vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Latif Ramadanit drejtor i DBF i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit me ndryshimet e cekura me lart, dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 23 vota për, 4 abstenime, aprovoi Vendim

Pastaj dha Kryesuesi pauzë nga ora 12:00 deri në ora 13:30

V

Diskutimi i Planit të veprimit për adresim të rekomandimeve të ZKA.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Safet Krasniqi ,auditor i mbrenshëm i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Besiana Sylja, tha se te zbatimi i rekomandimeve e kam shikuar deri te rekomandimi i 12-te ku këtu paraqesin problem taksat për ushtrimin e veprimtarisë të cilat ende ekzistojnë si borxhe nga viti 2014, të cilat ende nuk figurojnë e ku komuna duhet të ndërmarrë diçka ose t'i fshij me ndonjë vendim ose ndonjë veprim tjetër.

Safet Krasniqi, ky rekomandim na përsëritet edhe nga viti i kaluar, ne si komunë kemi bërë përpjekje që të kryhen borxhet në mënyrë të rregullt. Fshirja e borxheve kërkohen leje e Ministrisë së financave pastaj duhet të vij në kuvend si propozim.

VI

Diskutimi i Raportit të Auditorit të brendshëm dhe planit të veprimit për adresimin e rekomandimeve.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Safet Krasniqit, auditor i brendshëm, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Besiana Sylja, tha se te ky raport kam pas se disa rekomandime të auditorit të brendshëm nuk zbatohen, kish qenë mirë që kryetari t'i zbatoj këto rekomandime.

Lulzim Rustemi, tha se i falënderoj auditorët për punën që po e bëjnë, rekomandime mjaft profesionale. A ka rekomandime profesionale. Çka ndodh me rekomandimet që nuk zbatohen a ka ndëshkime?

Safet Krasniqi, tha se 59% të rekomandimeve janë zbatuar një pjesë janë duke u zbatuar ndërsa 10% nuk janë zbatuar ende. Por disa janë të ndërlydhura edhe me nivel qendror që na shkakton probleme.

VII

Propozim vendim për përcaktimin e formës, përmbajtjes dhe përdorimit të Flamurit të Komunës së Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Elmaze Behlulit, drejtoreshë e DA, e cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se e kam cek edhe atë ditë në mbledhje të KPF-së, a ka pas ndonjë komision kush ka qenë në atë komision kush e ka vendos ngjyrën e bardhë, kush ka vendos për këtë flamur.

Daut Azemi, momentin kur është vendos për stemën është dashtë me pas edhe flamurin por në atë kohë është harruar. Shumica e komunave e kanë ngjyrën e bardhë dhe stemën, por nëse keni ndonjë propozim tjetër e diskutojnë e arsyetojnë dhe kuvendi e vendos.

Arsim Jashari, tha se për me ardh propozimi është dashtë me dhanë komisioni propozim, por nuk ka pas komision që me pas pastaj edhe debat lidhur me flamurin.

Daut Azemi, tha se shumica e komunave e kanë me ngjyrë të bardhë.

Pastaj Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 19 vota për, 8 abstenime e aprovoi Vendimin.

VIII

Propozim Rregullore për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Imri Smetishtit drejtor i DPUMM, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 23 vota për, 4 abstenime, aprovoi rregulloren

IX

Propozim Vendim për ndarjen mjeteve financiare për qendrën për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve-Strehimoren në mbrojtje të viktimave të dhunës familjare dhe atyre të dhunës gjinore.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i'a kaloi fjalën Shkelzen Hajdinit DSH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se edhe ne KPF e kemi diskutua dhe do ta mbështesim, dhe duhet që kjo dukuri duhet të ndalet sa me shpejtë që është e mundur.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha na patëm një takim me përfaqësuesit e stacionit policor në Lipjan dhe diskutuam edhe këtë çështje. Unë nuk mendoj që është rrit numri i rasteve të dhunës në familje por janë rrit rastet te cilat po i raportojnë dhunën në familje dhe kjo është një vëdisim i mirë i popullatës në Kosovë.

Shkelzen Hajdini, tha se nuk kam konstatuar që është ne rritje numri i rasteve të dhunës, por kam konstatuar që është në rritje numri i raportimeve.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 26 vota për, aprovoi Vendim

X

Propozim Vendim për zëvendësimin anëtarit të komisionit vlerësues për shqyrtimin e dokumentacionit për vendosjen e bizneseve në Zonën Ekonomike "Parku Industrial" në Qylagë-faza e parë.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia kaloi fjalën Valon Pacollit DEZH i cili, i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha nëse e merrni në punë Bekimin, mos na qitni punë me i ndryshuar anëtarët e komisionet prapë.

Daut Azemi, konkursi ka qenë i hapur për të gjithë dhe ka aplikuar vetëm një kandidat

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 16 vota për,9 abstenime aprovoi Vendim

XI

Propozim vendim për ndryshimin e titullarit të paluajtshmërisë nga shkolla fillore Banullë në komuna Lipjan

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Rasim Hasanit drejtor i DKA, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Daut Azemi, tha se na e kemi obligim ligjor brenda 30 dite me rishqyrtuar këtë vendim.

Arsim Jashari, tha se a është problem këtu ndarja, apo emërtimi?

Rasim Hasani, tha se problemi është te destinimi qe të ndryshohet titullari, qe ne me aplikuar ne organizata të ndryshme.

Daut Azemi, me qetë vendim po e ndryshojmë titullarin

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 24 vota për,3 abstenime aprovoi Vendim

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 14,30

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi